



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA	
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTYRË CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. U. <u>01</u>	Mr. Br. <u>12435</u>
Nr. i fag. Br. str. <u>03</u>	Data: <u>22/05/2025</u>
KAMENICË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të nenit 7, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), dispozitive të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, dhe vendimit të Kuvendit Komunal të Kamenicës Sh.01.2669 të datës 03.02.2025 për formimin e komisionit për inicimin e procedurave për ndryshimin e stemës së Komunës së Kamenicës, Komisioni për Inicimin e Procedurave për Ndryshimin e Stemës së Komunës së Kamenicës, me datë 22.05.2025 shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për hartimin dhe dizajnimin e Stemës së re të Komunës së Kamenicës

Të drejtë pjesëmarrjeje në Thirrje Publike kanë të gjithë personat fizikë dhe juridikë, rezidentë dhe jorezidentë të Republikës së Kosovës, të cilët nuk janë anëtarë të komisionit për ndryshimin e stemës apo të komisionit profesional për përzgjedhjen e punimeve më të mira, dhe që nuk janë të angazhuar në punën e tyre nga këto komisione.

Propozimi për zgjidhjen ideore të stemës së Komunës së Kamenicës duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 dhe me Statutin e Komunës së Kamenicës, si dhe t'i përgjigjet karakteristikave historike, kulturore, natyrore dhe të tjera të Komunës së Kamenicës.

Propozimi nuk mund të ketë formë të njëjtë apo të modifikuar me simbolet shtetërore dhe kombëtare të Kosovës apo të shteteve të tjera, si dhe me logot e partive politike, shoqërive tregtare, institucioneve, subjekteve të tjera juridike dhe organizatave.

1. Kriteret e përgjithshme për hartimin e zgjidhjes ideore të stemës së Komunës:

- Numri, paraqitja dhe përmbajtja e fushave në modelin e propozuar të Stemës duhet të jetë e përshtatshme për praktikën heraldike;
- Stema duhet të punohet në dy variante themelore: (e ashtuquajtura stema e vogël) dhe ajo e zgjeruar, respektivisht zyrtare (e ashtuquajtura stema e mesme);
- Renditja dhe përmbajtja e fushave në mburojë duhet t'i plotësojnë kushtet e praktikës heraldike, dhe përmbajtja e tyre duhet të përputhet me kërkesat e Thirrjes Publike;
- Trajta dhe forma e stemës duhet të mundësojnë teknikën e printimit në disa ngjyra, dhe që

stema, si simbol, mund të përdoret për punimin e pllakave, diplomave, shenjave, mirënjohjeve publike, suvenireve dhe të ngjashme.

2. Kushtet e veçanta për paraqitjen e propozimit:

- a)** Propozimet që paraqesin idenë për Stemë duhet të bëhen me ngjyra dhe të paraqiten në fletë të veçanta të formatit A4;
- b)** Të paraqet pasqyrimin artistik të veprimitarisë dhe identitetit të Komunës së Kamenicës;
- c)** Të jetë origjinale, kreative, krijuese, cilësore, profesionale dhe përfaqësuese;
- d)** Të jetë lehtësisht e kuptueshme dhe të përçojë një mesazh të qartë;
- e)** Të jetë e dallueshme, e qëndrueshme në kohë dhe lehtë e mbajtur mend;
- f)** Të jetë e përshtatshme për përdorim në dokumente fizike dhe paraqitje elektronike, në sfond të bardhë dhe të errët;
- g)** Të jetë e përdorshme në madhësi të ndryshme, pa humbur qartësinë vizuale;
- h)** Të ketë shpjegim të detajuar për çdo simbol dhe ngjyrë të përdorur në stemë;
- i)** Në fletë të formatit A4 duhet të dorëzohet varianti "bardh-zi" i të njëjtës;
- j)** Në fleta të veçanta të formatit A4 duhet të dorëzohen shembuj të detajuar të aplikimit të stemës së propozuar në memorandumë, zarfe postare, kartëvizita, flamuj, uniforma dhe pjesë të tjera ku logo mund të aplikohet;
- k)** Propozimi mund të realizohet edhe me dorë, duke përdorur teknikën e ngjyrit (dush, tempera, akualet ose një kombinim i këtyre teknikave);
- l)** Vizatimet duhet të jenë me ngjyra dhe të paraqiten në fletë të veçanta formati A4, të koduara individualisht;
- g)** Përveç në letër, propozimi dorëzohet edhe në formë elektronike në formatin pdf dhe vektorial(CD/USB), me kodin e punimit të shënuar në media dhe në paketimin e saj.

3. Afati i dorëzimit të propozimeve, zgjedhja e tyre dhe shpërblimet:

a) Punimet dorëzohen në pako (zarf) me KOD, më së largu deri në ora 16:00 të ditës së fundit të Thirrjes Publike, në adresën: Komuna e Kamenicës, rr. Skënderbeu, 62000 Kamenicë, me mbishkrimin: Propozim për Dizajnimin e Stëmës së Komunës së Kamenicës.

b) Me punim, në zarf të veçantë të mbyllur, është e nevojshme të dorëzohen edhe të dhënat personale të pjesëmarrësve (emri dhe mbiemri, adresa e banimit dhe kontakti), si dhe deklarata e e nënshkruar se punimi është origjinal dhe krijim personal, si dhe se e drejta e autorit i transferohet Komunës së Kamenicës në rast se përzgjidhet.

c) Thirrja Publike zgjatë 60 ditë nga dita e publikimit.

4. Shpërblimet e propozuara janë si vijon:

a) Shpërblimi i parë 5000€

b) Shpërblimi i dytë 700€

c) Shpërblimi i tretë 500€

5. Kushtet e Thirrjes Publike

a) Çdo pjesëmarrës i Thirrjes Publike mund të marrë pjesë me më së shumti tri punime. Çdo punim duhet t'i dorëzohet komisionit si dërgesë (punim) e veçantë dhe me kod të veçantë, dhe me përmbajtjen e kërkuar.

b) Punimet që arrijnë pas skadimit të afatit prej 60 ditësh, nga dita e publikimit të Thirrjes Publike, nuk do të shqyrtohen.

c) Propozimet e pakompletuara, sipas konstatimit të komisionit, nuk do të shqyrtohen.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TE QY CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA	
Sh. U.	Nr. Br.
01	12435
Nr. i faq.	Data:
03	22/05/2025
Gr. str.	Datum:
	KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Na osnovu člana 7, stav 1 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 ("Službeni List Republike Kosova" Br. 28/2008), odredaba Statuta Opštine Kamenica Š 01, Br. 20203 od/datum 21.06.2023, i odluke Skupštine Opštine Kamenica o formiranju komisije za pokretanje procedura za izmenu grba Opštine Kamenica Š 01 Br. 2669 od./datum 03.02.2025, Komisija za Pokretanje Procedura za Izmenu grba Opštine Kamenica, dana 22.05.2025 godine objavljuje:

JAVNI POZIV

Za izradu i dizajn novog Grba za Opštinu Kamenica

Pravo učešća na Javni Poziv imaju sva fizička i pravna lica, stanovnici Republike Kosova i stanovnici van nje, koji nisu članovi komisije za izmenu grba ili profesionalne komisije za izbor najboljih radova, i koji nisu angažovani u njihov rad ovih komisija.

Predlog za idejni izbor grba Opštine Kamenica treba da je usaglašen sa Zakonom o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 i sa Statutom Opštine Kamenica, kao i odgovarati istorijskim, kulturnim, prirodnim i drugim karakteristikama Opštine Kamenica.

Predlog ne može imati isti oblik ili biti modifikovan sa državnim i nacionalnim simbolima Kosova, ili drugih država, kao i sa logom političkih partija, privrednih društava, institucija, drugih pravnih i organizacionih subjekata.

1. Opšti kriteriji za izradu idejnog rešenja za grb Opštine:

- Broj, prezentacija i sadržaj polja u predloženom modelu Grba mora biti prikladan za heraldičku praksu;
- Grb treba raditi u dve osnovne varijante: takozvani mali grb) i onaj prošireni, odnosno službeni (takozvani srednji grb);
- Redosled i sadržaj polja u štitu moraju ispuniti uslove heraldičke prakse, i njihov sadržaj mora biti usaglašen sa zahtevima Javnog Poziva;
- Oblik i forma grba moraju omogućiti tehnike štampanja u nekoliko boja, i da se grb, kao simbol može koristiti za izradu ploča, diploma, znakova, javnih priznanja, suvenira i sl.

2. Posebni uslovi za prijavu predloga:

- a) Predlozi koji predstavljaju ideju za Grb moraju se uraditi u bojama i moraju se prikazati na posebnu listu formata A4;
- b) Da predstavi umetnički odraz delatnosti i identiteta Opštine Kamenica;
- c) Ta je originalan, kreativan, kvalitetan, profesionalan i reprezentativan;
- d) Da je lako razumljiv i prenese jasnu poruku;
- e) Da se razlikuje, stabilan na vreme i lako zapamtiti;
- f) Da je pogodan za upotrebu u fizičkim dokumentima i elektronskoj verziji, na beloj i tamnoj podlozi;
- g) Da je upotrebljiv u raznim veličinama, bez gubitka vizuelne jasnoće;
- h) Da ima detaljno objašnjenje za svaki simbol i korišćenu boju na grbu;
- i) Na listi formata A4 mora se dostaviti „crno bela“ verzija iste;
- j) Na posebnoj listi formata A4 moraju se dostaviti detaljni primeri predložene primene grba u memorandumima, poštanskim kovertima, vizit kartama, uniformama i u drugim delovima gde se logo može primeniti;
- k) Predlog može se realizovati ručno, koristeći tehniku bojenja (tuš, tempere, akvarel ili neka druga kombinacija ovih tehnika);
- l) Crteži moraju biti u boji i predstavljeni na posebnom listu formata A4, pojedinačno kodirani;
- g) Osim na papiru, predlog se dostavlja i u elektronskoj formi na formatu pdf i vektor (CD/USB), sa oznakom rada označenom u medijima i njegovom pakovanju.

3. Rok za podnošenje predloga, njihov izbor i nagrade:

- a) Radovi se dostavljaju u paketu (koverat) sa KODOM, najkasnije do 16:00 časova poslednjeg dana Javnog Poziva, na adresu: Opština Kamenica, ul. Skënderbeu, 62000 Kamenica, sa natpisom: Predlog za Dizajn Grba Opštine Kamenica.

b) Sa radom u posebnoj zatvorenoj koverti, potrebno je dostavljanje ličnih podataka učesnika (ime i prezime, adresa stanovanja i kontakt), kao i izjava potpisana da je delo originalno i lično stvaralaštvo, te da se autorsko pravo prenosi na Opštinu Kamenica ako se bira.

c) Javni Poziv traje 60 dana od dana objavljivanja.

4. Predložene nagrade su sledeće:

a) Prva nagrada 5000€

b) Druga nagrada 700€

c) Treća nagrada 500€

5. Uslovi Javnog Poziva

a) Svaki učesnik Javnog Poziva može učestvovati sa najviše tri rada. Svaki rad mora se dostaviti komisiji kao poseban podnesak (rada) sa posebnim kodom, i sa traženim i potrebnim sadržajem.

b) Radovi koji pristižu po isteku roka od 60 dana, od dana objavljivanja, neće se razmotriti.

c) Netpuni predlozi koji utvrdi komisija, neće se razmotriti.

